

Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **28.05.2014**, pas shqyrtimit të Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

Neni 1

Ipet në diskutim publik Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 29.05.2014 dhe zgjatë deri më 17.06.2014.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Neni 4

Obligohet Kryetari i komisionit që si hartues dhe propozues i Propozim-vendimit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu Kryetari i komisionit obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-statutit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Qershor 2014.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 28.05.2014, pas shqyrtimit të Draft-rregulloreve për organizimin e punës dhe mësimimit në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

Neni 1

Ipen në diskutim publik Draft-rregulloret për organizimin e punës dhe mësimimit në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta .

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 29.05.2014 dhe zgjatë deri më 17.06.2014.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer m masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Arsim që si hartues dhe propozues i Draft-rregulloreve në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DA-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-statutit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Qershor 2014.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **28.05.2014**, pas shqyrtimit të Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

Neni 1

Ipen në diskutim publik të Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 29.05.2014 dhe zgjatë deri më 17.06.2014.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale që si hartues dhe propozues i Draft-rregulloreve në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DSHPS-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-statutit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Qershor 2014.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 120 / 14

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 28.05.2014

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 si dhe nenin 40.2 "dh" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 28.05.2014, mori këtë:

V E N D I M PËR RIDESTINMIN E MJETEVE BUXHETORE TË KOMUNËS

Neni 1

1.1. Me këtë vendim bëhet ridestnimi i mjeteve nga fondi burimor 10 nga kategoria e investimeve kapitale, programi 664250, Planifikimi Urban dhe Mjedis dhe programi 644180 Shërbime Publike, Mbrojtje Civile dhe Emergjencja nga këto programe:

1.1.1. Kodi i projektit 690249 Asfaltimi i rrugës Kollë në vlerë 67,500.00€, shuma e mbetur e mjeteve të lira buxhetore **11,103.50€**;

1.1.2. Kodi i projektit 90251 Asfaltimi i rrugës Bukosh-Bruzniç në vlerë 40,869.00€, shuma e mjeteve të lira buxhetore **2,707.50€**;

1.2. Nga projektet e cekura në nënparagrafët: 1.1.1, 1.1.2 të këtij vendimi ridestnohen mjetet në shumën prej **13,811.00 €**, në të njëjtin program buxhetor për realizimin e Projektit Asfaltimi i rrugës hyrje-dalje te Komuna, kodi 90252, shuma 13,811.00€.

1.3. Kodi i projektit 90225 Bashkëfinancimi me donator në vlerë 100,000.00€, shuma e mjeteve prej 30,000.00 € ridestnohen në të njëjtin program buxhetor në këto projekte:

1.3.1. Ndërtimi i Palestrës Sportive në Samadrexhë, shuma 20,000.00 €;

1.3.2. Renovimi i shkollës fillore "Ali Kelmendi", shuma 4,000.00 €;

1.3.3. Renovimi i shkollës fillore "Mustafë Venhari" shuma 6,000.00 €.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit
Shpëtim Zhegrova



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 121 / 14

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 28.05.2014

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 11,12 dhe 40.2"ç" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 41.2 "ç" të Statutit të komunës, si dhe Vendimit të KK-së 01.Nr.222/12, dt. 26.09.2013 me të cilin aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, KAB-i dhe lista e projekteve prioritare për vitin 2014, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 28.05.2014, mori këtë:

**VENDIM
PËR SHPËRNDARJEN E MJETEVE NGA FONDI PËR TRANSFERE DHE
SUBVENCIONE**

Neni 1

Me këtë vendim, mjetet buxhetore të komunës- fondi për transfere dhe subvencione për aktivitete kulturore, rinore dhe sportive për vitin 2014, nga vlera totale prej 29,375.00 €, ndahet:

- a. Shuma prej 2,500.00 € (dymijë e pesëqind euro)për subvencionim të lojtarëve të Klubit të Futbollit "Llamkos";
- b. Shuma prej 1,000.00 € (njëmijë euro) për Klubin e Tifozëve "FORCA".

Neni 2

Mjetet në shumën e cekur si në nenin paraprak, do të ndahen në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me Rregulloren për Përcaktimin e Kriterëve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndihmë Momentale Entiteteve Publike dhe Jopublike 01Nr.37-2/11, dt.24.02.2011, si dhe pas dorëzimit të raportit nga përfituesit e këtij fondi për shfrytëzimin e mjeteve nga viti 2013.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit
Shpëtim Zhegrova



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br. <u>122/14</u>
Nr. i fq. / Br. si <u>-1-</u>
Data: / Datum <u>28.05.2014</u>
VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të komunitetit turk të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 28.05.2014, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR.23/14, DT. 30.01.2014

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet vendimi i Kuvendit të Komunës për emërim të anëtarëve të Komitetit për Komunitete 01Nr.23/14, dt. 30.01.2014 si në vijim: në nenin 1 pika 3, në vend të Enver Dubovci, duhet të jetë Berat Maxhuni.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Sekretaria e Kuvendit.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	123/14
Nr. i fq. / Br. st	-1-
Data: / Datum	28.05.2014
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtri

Në bazë të nenit 40.2 "c" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, nenit 40.2, "dh" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe nenit 8 të Rregullores mbi përcaktimin e kriterëve të ndarjes së subvencioneve entiteteve publike dhe jo publike dhe ndihmës momentale në të holla 01Nr 37-2/11 të datës 24.02.2011, si dhe kërkesës së Naim Maxhunit të dt. 14.05.2014, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **28.05.2014**, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDIHMË FINANCIARE PËR SHËRIM

Neni 1

Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i komunës - fondi për subvencione për Belxhyzare Maxhunin, me banim në Vushtrri, në shumën prej 2.500 € (dy mijë e pesëqind euro).

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij vendimi ndahet për ta ndihmuar financiarisht lidhur me shpenzimet për shërim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 40.2 "c" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40, nenit 40.2, "dh" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe nenit 8 të Rregullores mbi përcaktimin e kriterëve të ndarjes së subvencioneve entiteteve publike dhe jo publike dhe ndihmës momentale në të holla 01Nr 37-2/11 të datës 24.02.2011, si dhe kërkesës së Ismet Ramës të dt. 26.05.2014, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **28.05.2014**, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDIHMË FINANCIARE PËR SHËRIM

Neni 1

Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i komunës - fondi për subvencione për Ismet Ramën, me banim në fshatin Stanoc i Poshtëm, Komuna Vushtrri, në shumën prej 600 € (gjashtëqind euro).

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij vendimi ndahet për ta ndihmuar financiarisht lidhur me shpenzimet për shërim.

Neni 3


Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 7 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës Nr.04/L-144, nenit 4 të Rregullores QRK NR.23/2013 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, nenit 40.2 pika (k) të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më 28.05.2014, mori këtë:

V E N D I M PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE

Neni 1

1.1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronave të paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, të cilat gjenden në këto lokacione:

1.1.1. Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Adem Jashari" ngastra kadastrale nr.P-653, zona kadastrale Vushtrri, pronë e komunës e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 182 m² dhe e cila është e propozuar të ndahet në katërmbëdhjetë hapësira me nga 13 m².

1.1.2. Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Tirana" ngastra kadastrale nr.P-256, zona kadastrale Vushtrri pronë e komunës e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 36 m² dhe e cila është e propozuar të ndahet në katër hapësira me nga 9m².

1.1.3. Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Kruja" ngastra kadastrale nr.P-1102, zona kadastrale Vushtrri, pronë e komunës e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 51 m² e cila është e propozuar të ndahet në pesë hapësira tri me nga 9m² dhe dy me nga 12m².

1.1.4. Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Dëshmorët e Kombit" ngastra kadastrale nr. P-1116 dhe P-494/1 zona kadastrale Vushtrri, prona të komunës, të cilat përfshijnë një sipërfaqe ndërtuese prej 64 m² dhe e cila është e propozuar të ndahet në dy hapësira me nga 32m².

1.1.5. Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Xhon Buzuku" ngastra kadastrale nr. P-420/2 zona kadastrale Vushtrri pronë e komunës e cila përfshin një sipërfaqe prej 47 m² dhe e cila është e propozuar të ndahet në tri hapësira një me 9m², një me 12m² dhe një me 26m².

1.1.6. Lokacioni i cili gjendet me lokalet në rrugën "Jeton Tërrstena" ngastra kadastrale nr. P-2254/49, zona kadastrale Vushtrri prona të komunës të cilat përfshijnë një sipërfaqe prej 133 m², për të cilat është propozuar të jepen sipas skicës:

- *Lokali nr.1 me sipërfaqe prej 16m²,
- * Lokali nr.2 me sipërfaqe prej 12m²,
- * Lokali nr.3 me sipërfaqe prej 11m²,
- * Lokali nr.5 me sipërfaqe prej 11m²,
- * Lokali nr.7 me sipërfaqe prej 21m²,
- * Lokali nr.8 me sipërfaqe prej 62m²

1.1.7. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë edhe skicat e lokacioneve të përcaktuara si dhe certifikatat e njësisë kadastrale.

Neni 2

2.1. Pronat e cekura si në nenin 1 të këtij vendimi jepen në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit personave fizik dhe juridik, si objekte të karakterit të përkohshëm (montazh), në kohëgjatje prej 5 viteve me mundësi vazhdimi edhe për 5 vite.

2.2. Çmimi fillestar për m² është 2.00 € në muaj.

2.3. Investimet për ndërtimin e lokaleve afariste i bart fituesi i ankandit.

2.4. Të gjitha shpenzimet të cilat kanë të bëjnë me lokalit, i bart shfrytëzuesi i ankandit.

2.5. Komuna rezervon të drejtën e shkëputjes së njëanshme të kontratës, në këtë rast komuna duhet ta njoftojë shfrytëzuesin e lokalit 3 muaj para ndërprerjes së kontratës.

Neni 3

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimit të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit
Shpëtim Zhegrova





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 41.2 pika "d" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **28.05.2014**, mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT LOKAL PËR VEPRIM NË MJEDIS PËR KOMUNËN E
VUSHTRRIË

Neni 1

Me këtë vendim për aprovimin e planit lokal për veprim në mjedis për Komunën e Vushtrrisë për periudhën 2014-2019, i cili ka për qëllim krijimin e bashkëpunimit në mes të shoqërisë civile, publikut, pushtetit lokal dhe qendror.

Neni 2

Plani lokal për veprim në mjedis, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi është në përputhje të plotë me planin e Republikës së Kosovës për mbrojtje të mjedisit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Inspektime, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shërbime Publike.


Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit



Shpëtim Zhegrova



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 40.2 "h" të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 40 "gj" të Statutit të Komunës, si dhe në Rregulloren Nr. 186/13, dt.25.07.2013 për Dhënien e Dekoratave, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **28.05.2014** mori këtë:

V E N D I M

PËR NDARJE TË MIRËNJOHJEVE PËR NDER TË DITËS SË ÇLIRIMIT

Neni 1

1.1. Me këtë vendim për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, më 17 qershor 2014, nderohen me Titullin "Nderi i Qytetit" siç vijon:

1.1.1. **Safet (Haki) Ajeti – dëshmor i kombit**, në shenjë respekti për kontributin e madh në çlirimin e Kosovës, i cili ra në altarin e lirisë me 14.06.1999 në Begunc-Viti.

1.1.2. **Ilaz Kolla (post mortum)**.

1.1.3. **Aziz Bici**, për rezultatet në luftë si komandant i shquar i UÇK-së.

1.1.4. **Qazim Uka**.

1.2. Me mirënjohje nderohen:

1.2.1. **Illir Izmaku**, mësimdhënës i Edukatës Fizike në SHMU-1, për rezultate të mira me nxënës në nivel vendi, dhe për performancë të mirë në si futbollist aktiv në superligën e Kosovës.

1.2.2. **Lirie Ferizi**, zyrtare për arsimin e mesë të ulët, për rezultatet e dëshmuara në fushën e arsimit.

1.2.3. **Agron Gërxhaliu**, nxënës maturant në Gjimnazin "Eqrem Çabej" Vushtrri për suksese të shkëlqyeshme në shkollë.

1.2.4. **Amire Hyseni**, nxënëse – maturanthe në Gjimnazin "Eqrem Çabej" Vushtrri për rezultate të dalluara në aktivitetet shkollore.

1.2.5. **Skender Kapiti**, për kontributin e tij në ngritjen e qendrës për mobilizimin dhe sistemin e vullnetarëve ardhur nga diaspora për çlirimin e Kosovës.

1.2.6. **Rexhep Gyndyz**, nga Bursa – Turqi, për kontributin e tij në binjakëzimin e katër shkollave të Komunës së Vushtrrisë me shkollat simotra të Komunës Osmangazit të Bursës-Turqi.

1.2.7. **NNP "Nuhi Ujkani"**, për sukseset e arritura në zhvillimin e kapaciteteve prodhuese të materialeve për suvatim.

1.2.8. **SH.P.K Agrovin – Ramadan Kasumi**, për rezultatet të dalluara në kultivimin dhe prodhimin e patates.

1.2.9. **Firma: DPZ "Bunjaku" Vushtrri**, pronari **Edis Bunjaku**, për të arritura në veprimtarinë: metal gdhendës, dhe për ofrimin e mundësisë për zhvillimin e praktikës së nxënësve SHMT "Lutfi Musiqi".

1.2.10. **Nesim Ispahiu**, për kontributin e tij në fushën e artit.

1.2.11. **Fazli Rashica**, për kontributin e tij afirmativ në lëmin e muzikës.

1.2.12. **Klubi i Basketbollit "Vushtrria Basket"** për të arriturat e dëshmuara në basketboll.

- 1.2.13. **Nimon Ferizi, (post mortum)** për aktivitetin e dalluar për çështje kombëtare, pjesëmarrës në demonstratat e vitit 1982, i përjashtuar nga procesi mësimor nga regjimi pushtues serb në v. 1981, si dhe pjesëtar i UÇK-së.
- 1.2.14. **Jahja (Rrahim) Mehmeti-** për kontributin e tij si ushtar i dalluar i UÇK-së, dhe i plagosur në luftë.
- 1.2.15. **Sebahate Braha, ish-punëtore e Administratës Komunale-** për rezultate të dalluara në punë në administratën komunale.
- 1.2.16. **Mexhit (Hashim) Bunjaku, bashkatdhetar joni nga Norvegjia-** për kontribut në ofrimin e donacioneve prej 3 autobusëve për SHMT "Lutfi Musiqi".
- 1.2.17. **Hysen Hyseni-** veteran i UÇK-së.
- 1.2.18. **Bahri Bivolaku,** si punëtor i dalluar shumëvjeçar.
- 1.2.19. **Sevëme Fetiçi,** për kontributin e saj në letërsi.
- 1.2.20. **Vehbi Haxha,** për kontributin në luftë.
- 1.2.21. **Xhevat Deliu,** i burgosur politik.
- 1.2.22. **Behram Muharremi,** i përndjekur politik.
- 1.2.23. **Kujtim Hoti,** veprimtar i dalluar, i përndjekur nga regjimi okupator (mirënjohje).
- 1.2.24. **Haki Mikullofci,** ish-punëtor i administratës.
- 1.2.25. **Bahire Dërguti,** veterane e arsimit.
- 1.2.26. **Fahredin Gynler,** biznesmen i njohur dhe kontribuues i çështjes kombëtare shqiptare.
- 1.2.27. **Remzi Klinaku, (post-mortum),** veteran i UÇK-së.
- 1.2.28. **KF "LLAMKOS KOSOVA".**
- 1.2.29. **Ismet Munishi,** trajner i KF "Llamkos Kosova".
- 1.2.30. **Klubit të Tifozëve "FORCA".**
- 1.2.31. **Myrvete Pantina,** si veprimtare e dalluar.
- 1.2.32. **Gjylsime Feka,** si veprimtare e dalluar.
- 1.2.33. **Behar Dushi,** për kontributin e tij në ndihmë për sigurimin e ujit për shkollat e komunës.
- 1.2.34. **Blerim Feka,** për ndihmën e ofruar për shoqatën e martirëve.
- 1.2.35. **Zehra Maxhuni,** veterane e arsimit.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, si dhe Sekretaria e Kuvendit.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

